



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo

02/47437-20/20-20		
Shifra	Numri	Hj. org.
1	21.09.20	20



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E KACANIKUT
OPSTINA KACANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë; dhe G.O "Ream Company" shpk&N.T.SH. "Rema" na Kaçaniku me NRB 810060418 të cilën e përfaqëson Arbe Guri me ID-1232956883 nga f. Nikaj Kaçaniku (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

"Rregullimi i infrastrukturës së fshatit Bob" me numër identifikues: **652/20/4222/5-2-1 (KA652/20/063/521)**.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

"Rregullimi i infrastrukturës së fshatit Bob"

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 14.946,50€;
(Katermbdhjetëmijëenandqindekaterdhjetegjashteeuro dhe 50/100€).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin dhe atë: Në bazë miratimit të Menagjerit të Projektit vasrësishtë nga ekzekutimi i punëve në teren pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit të projektit, ndërsa situacioni përfundimtar paguhet pas raportit përfundimtar të menagjerit të projektit si dhe raport teknik të komisionit për pranim teknik të punëve.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferat financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- Plani mbi menaxhimin e Kontrates.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	21.09.2020
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Arber Guri
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	21.09.2020
Vula:	



Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin rëndomjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	

Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e Vlerës së Kontratës apo 1.494.65€.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhunuar është 30 ditë pune.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 24.09.2020 ku i gjith plani dinamik aratohet në ditar ndërtimor.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Regjistrat duhet të jenë të evidentuara në ditaret ndërtimorë
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mengjaer i Projekti : Ilir Koraqi Pagesat do të behen pas miratimit nga Menaxheri i Projektit duke raportin e puneve te kryera.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë nga 10% e vlerës së pageses e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 tre ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365+30 ditë

Defektet		
Pagesa shkëputjes kontratës pas së	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>10% të vlerës së kontratës.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Bzuar në Ligjetnë fuqi</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetent</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

Paramasa dhe Paralogaria					
Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Bob					
I.	Punët Paraprake				
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1.1	Shënimi i trasës dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	140.00	0.10	14.00
Gjithsej I:					14.00


II.	Punët tokësore				
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë IV-V, , me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max 15km. .	m ³	420.00	0.80	336.00
2.2	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazes së trupit të rrugës deri në modulën e ngjeshmërisë 40 MN/m2	m ²	840.00	0.10	84.00
Gjithsej II:					420.00

III	Punët e zhavorit				
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
3.1	Furnizimi,nivelizimi dhe ngjeshja e zhavorit nga guri i thyer gëlqeror Fr 0-63 mm në trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur dhe modul të ngjeshmërisë ≥70Mpa.	m ³	186.00	2.50	465.00
3.2	Furnizimi,nivelizimi dhe ngjeshja e zhavorit nga guri i thyer gëlqeror Fr 0-31 mm në trashësi t=10cm në gjendje të ngjeshur dhe modul të ngjeshmërisë ≥70Mpa.	m ³	81.00	3.00	243.00
Gjithsej III:					708.00

IV.	Punët e kubëzave të betonit				
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
4.1	Sigurimi, transporti dhe montimi i gurëve skajor b/h= 18/24 cm, të klasës " T " sipas standartit EN1340:2003. Në llogari hyn edhe punimi i bazës prej betoni C25/30 me trashësi 10cm dhe sigurimi me beton ndaj prapëtimit sipas detalit.	m'	240.00	5.70	1,368.00
4.2	Sigurimi, transporti dhe montimi i kubëzave të betonit me trashësi t=8 cm. Në llogari hyn edhe rëra Fr II(4-8mm) me trashësi 3-5cm për nivelizim, ngjeshja e pllakave pas montimit, mbushja e fugave me rërë 0-4mm dhe pastrimi përfundimtar i tyre.Dizajni dhe modeli i kubëzave caktohet nga organi mbikëqyrës. Kubëzat duhet ti plotësojnë kërkesat e soliditetit sipas standartit EN 1338:2003, EN1340:2003 (soliditeti në çarje >3.60MPa)	m ²	790.00	7.80	6,162.00
Gjithsej IV:					7,530.00


V	Punimi i murit mbrojtës				
---	-------------------------	--	--	--	--

W



5.1	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV, duke përfshirë edhe humusin, me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 10km.	m ³	240.00	0.80	192.00
5.2	Furnizimi dhe vendosja e tamponit nën themele zhavor 0-63 me trashësi t=20cm	m ³	18.00	3.00	54.00
5.3	Kthimi i dheut të gërmuar mbrapa mureve mbrojtëse pas punimit të drenazhes dhe përshtatja me skarpatën e terenit	m ³	180.00	0.50	90.00
5.4	Furnizimi dhe vendosja e gypave për drenazhim tërthor Pvc Ø 110mm	m'	15.00	2.50	37.50
5.5	Furnizimi dhe vendosja e gypave për drenazhim HDPE i brinjëzuar me vrima për drenazhim Ø160mm	m'	60.00	2.00	120.00
5.5	Furnizimi dhe punimi i drenazhës mbrapa murit me zhavor Fr IV (16-31.5mm)	m ³	60.00	3.00	180.00
5.6	Furnizimi dhe vendosja e betonit të varfër t=10 cm nën pllakën e themelit. Klasa e betonit C16/20	m ³	9.00	50.00	450.00
5.7	Furnizimi dhe vendosja e betonit C25/30 për ndërtimin e murit mbajtës sipas detalit. Të përfshihet edhe punimi i pahive të zakonshme dhe elementeve tjera përcjellëse	m ³	53.40	50.00	2,670.00
5.8	Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave (ø8mm, ø10mm, ø12mm) duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte para betonimit. Vlera karakteristike e kufirit të njëdhjes (yield strength characteristic value) f _{yk} =500 N/mm ²	kg	4,272.00	0.40	1,708.80
Gjithsej V:					5,502.30

V	Punët e trajtimit të ujërave atmosferike				
6.1	Gërmimi i dheut i kategorisë IV-V, me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max 15km, për hapjen e pusetave të ujëmbledhësve dhe kanaleve për kyçje deri në pusetën e kolektorit kryesor.	m ³	7.20	1.00	7.20
6.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta të ujëbledhësve me betonarme C- 25/30 d=20cm	m ³	1.20	50.00 €	60.00 €
6.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për kineta më përpunim sipas detalit.	m ³	1.20	50.00 €	60.00 €
6.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave prej betonit të armuar Ø400/1000mm për pusetat e ujëmbledhësve.(elemente të parafabrikuara).	copë	6.00	20.00 €	120.00 €
6.4	Hapja e vrimës në pusetën kryesore monolite betonarme për depërtimin e gypit të ujëmbledhësit, duhet të përdoret makineri adekuate për depërtim në beton	copë	6.00	10.00 €	60.00 €



6.5	Nivelizimi i kapakëve të pusetave ekzistuese me rrugë, në çmim duket të përfshihet demolimi i kapakëve duke i ruajtur dhe montimi përsëri i tyre me kurorë prej betoni te armuar t=20cm	copë	7.00	15.00 €	105.00 €
6.6	Furnizimi, transporti, montimi i kapakëve nga materiali prej gize rrethor me aftësi mbajtëse 40t me kurorë prej betoni te armuar t=20cm. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	1.00	60.00 €	60.00 €
6.7	Furnizimi, transporti dhe montimi kapakëve të pusetave për ujëbledhësat në formë grille (nga çeliku i shkrirë) me aftësi mbajtëse 40t. Në çmim të llogarohet betoni i kurorës sipas detalit të dhënë prej betonarmesë C-25/30.	copë	6.00	50.00 €	300.00 €
Gjithsej VI:					772.20 €

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM		
I.	Punët e demolimit dhe pastrimit	14.00 €
II.	Punët tokësore	420.00 €
III.	Punët e zhavorit	708.00 €
IV.	Punët e kubëzave të betonit	7,530.00 €
V.	Punimi i murit mbrojtës	5,502.30 €
VI.	Punët e trajtimit të ujërave atmosferike	772.20 €
Totali:		14,946.50 €

Vërejtje!
Të gjitha çmimet e pozicioneve duhet të jenë të llogaritura me TVSH.
Në të gjitha pozicionet nënkuptohet furnizimi dhe transporti i të gjitha materialeve duke e llogaritur edhe punën për realizimin e pozicionit, më të gjitha elementet përcjellëse.
Të gjitha materialet para përdorimit duhet të prezentohen për miratim nga organi mbikëqyrës.
Punëkryesi duhet që me kujdes të realizoj punën, pasi për çdo dëmtim të instalimeve (ujësjellësit, kanalizimit, rrymës, etj.), i bartë shpenzimet për rregullimin e defekteve eventuale.
Punëkryesi i bartë shpenzimet për të gjitha atestet e materialeve dhe ekzaminimeve të cilat nevoiten në këtë rast dhe atestet dhe ekzaminimet shtesë të cilat kërkohen nga organi mbikëqyrës.
Gjatë punimeve punëkryesi është i obliguar të vendos shenjat për punime në rrugë.

E Punuar nga: Eljesa Begunca

korrik 2020

